



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1517 Prot.

Durrës, më 29.9.2023

VENDIM  
Nr 56, datë 29.9 2023

**PËR**

**“MIRATIMIN E KALENDARIT AKADEMIK PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE DHE PROGRAMET 2-VJEÇARE ME KARAKTER PROFESIONAL, ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024, NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS”.**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 “Për riorganizimin e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Statutit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, të Rregullores së Universitetit “Aleksandër Moisiu”, të vendimit të Rektoratit nr. 9, datë 29.09.2023,  
Senati Akademik

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Kalendarit Akademik për programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet 2-vjeçare me karakter profesional, me kohë të plotë, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - ✓ Zv. Rektorët.
  - ✓ Administratori
  - ✓ Drejtuesit e Njësive Kryesore.
  - ✓ Drejtuesit e Njësive Bazë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Prof. Dr. Ksënela SOTIROFSKI**

